



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 683 / Prot
4

Tiranë, më 13 . 5 .2022

VENDIM

Nr. 14 , datë 13 . 5 .2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 683 Prot., datë 30.03.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 10.03.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Për kontratën e lidhur mes OST dhe kompanisë DH Albania, për ndërtimin e linjës 220 kilovolt Burrel-Peshkopi dhe traktin dalës të nënstacionit të Burrelit, cilat kanë qenë kriteret vlerësuese për firmën fituese të këtij tenderi?
2. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e thirrjes së hapur për tender publik për shfaqje interesi;
3. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e kritereve vlerësuese për ofertuesit pjesmarrës;
4. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e kontratës së lidhur mes OST dhe DH Albania, e firmosur nga palët kontraktore;

5. Në njoftimin e bërë nga OST në datë 11.12.2018, është thënë që kontrata në fjalë është pezulluar. A është anuluar kjo kontratë në vijim të hetimeve dhe gjetjeve të gjykatave vendase të veprimeve të kundraligjshme nga ana e DH Albania?
6. Për lidhjen e kësaj kontrate, a ka vënë garanci kontraktore DH Albania?
7. Sa është shuma e kësaj garancie kontraktore?
8. A është sekuestruar/tërhequr kjo garanci nga ana e OST në rast të anulimit të kontratës me DH Albania?
9. Në zbatimin e kësaj kontrate a ka bërë OST ndonjë pagesë kundrejt DH Albania? Nëse po, sa dhe në çfarë datash?
10. Nëse janë bërë pagesa nga ana e OST, çfarë ka ndodhur me to pas anulimit të kontratës?

Autoriteti Publik, me shkresën *kthim përgjigje* datë 23.03.2022, ka kthyer përgjigje me argumentet përkatëse në lidhje me kërkesën për informacion të paraqitur nga ankuesi.

Pas përgjigjes së sipërcituar, Ankuesi e ka konsideruar të pjesshëm informacionin e vendosur në dispozicion nga Autoriteti Publik, për sa i përket pikave 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, duke pretenduar se nuk i është vendosur në dispozicion një përgjigje specifike, por i referon faqen online të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 683/1 prot., datë 04.04.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2242/1 Prot., datë 11.04.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 683/2 Prot., datë 12.04.2022, ka sqaruar se për pikat 1, 2 dhe 3 të kërkesës për informacion mban të njëjtin qëndrim të mbajtur më parë, me argumentin se “*Procedura e prokurimit me objekt: “Linja e re 220 KV Burrel – Peshkopi dhe trakti dalës i N/st Burrel” e zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ka qenë një procedurë e hapur me mjete elektronike dhe si e tillë të gjitha njoftimet në lidhje me të janë publikuar në sistemin e prokurimit publik të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)*”

konform kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar. Çdo informacion në lidhje me këtë procedurë, të tilla si njoftimi i kontratës, dokumentat e tenderit, procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, njoftimi i fituesit, njoftimi i lidhjes së kontratës etj. gjendet dhe është i aksesueshëm nga çdo individ në faqen e APP".

Ndërsa në lidhje me pikën 4 të kërkesës ka refuzuar dhënien e informacionit me arsyetimin se: *"... Kopja e plotë e kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve nuk mund t'i vihet në dispozicion z. Hoxha, pasi kontrata përmban informacione konfidenciale sipas përcaktimeve të nenit 16 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në këto kushte ndodhemi përpara rastit të kufizimit të së drejtës për informim sipas nenit 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"*".

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 683/3 Prot., datë 12.04.2022, duke rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në ankesë.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesave ka të bëjë me kontrata të punëve publike, të cilat i nënshtrohen gjithashtu dispozitave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë periudhë), si dhe ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik për pikat 1, 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, sipas së cilit: *"Çdo informacion në lidhje me këtë procedurë, të tilla si njoftimi i kontratës, dokumentat e tenderit, procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, njoftimi i fituesit, njoftimi i lidhjes së kontratës etj. gjendet dhe është i aksesueshëm nga çdo individ në faqen e APP"*, Komisioneri e gjen të pa bazuar. Në përgjigjen e dhënë ankuesit, konstatohet se Autoriteti Publik ka referuar fajten zyrtare të institucionit, ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresën e saktë të saj, ku informacioni të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *"Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni..."*. Për rrjedhojë Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Përsa i përket argumentit se “... *Kopja e plotë e kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve nuk mund t'i vihet në dispozicion z. Hoxha pasi kontrata përmban informacione konfidenciale sipas përcaktimeve të nenit 16 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në këto kushte ndodhemi përpara rastit të kufizimit të së drejtës për informim sipas nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”*”, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar, nuk provon që dokumentacioni i kërkuar, të cilin ka refuzuar, konsiderohet si konfidencial nga legjislacioni i posaçëm.

Konkretisht, Neni 25 “*Fshehtësia e procesit*” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohen se: - *Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.*

Neni 21 “*E drejta për informim*” i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakton se:..... “1. *Informacioni i administruar sipas nenit 12 të këtij ligji i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar me kërkesë të tij, pasi është përcaktuar oferta fituese apo pasi procedurat e prokurimit kanë përfunduar pa përcaktuar fitues. Kërkesat për informacion mund të paraqiten në çdo çast dhe autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës.*”.

Ndërkohë, Neni 12 “*Përgjegjësia e autoritetit kontraktor*” i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakton se: ...“2. *Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna: a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës; b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar; c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente; ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës; d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre; dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi; e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave; ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi; f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji; g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.*”. 3. *Autoriteti kontraktor krijon një regjistër që administrojnë të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit.*”.

Në të njëjtën linjë, qëndron dhe ligji në fuqi nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili në nenin 16 “Konfidentaliteti”, parashikon se: “1. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje. 2. Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.

3. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, dhe pa cenuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave. 5. Autoriteti ose enti kontraktor nuk do të bëjë publike informacionin konfidencial, të dhënë nga kandidati ose ofertuesi që merr pjesë në negociata ose dialog, në një procedurë konkurruese me negociim, procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, dialog konkurrues ose partneritet për inovacion, pa dhënie të pëlqimit të këtij të fundit, me anë të një deklarate me shkrim. Kjo deklaratë nuk mund të përdoret si pengesë për aksesimin e të gjitha informacioneve, por duhet të lidhet vetëm me informacionin në fjalë.”

Referuar dispozitave të sipërcituara, Komisioneri vlerëson se kontrata e prokurimit publik nuk futet në kategorinë e informacionit të parashikuar, si konfidencial apo i fshehtë, që duhet të kufizohet për publikun. Në çdo rast, sipas pikës 3 të nenit 16 të ligjit të sipërcituar, nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë, argumentim i cili nuk është paraqitur nga ana e Autoritetit Publik. Për më tepër, fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimin publik, është të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.

Po ashtu, Komisioneri vlerëson se, bazuar në pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit parashikohet se: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të informacionit.

Gjithashtu, theksojmë se, bazuar në germën ë), pika 1, të nenit 7 të LDI dhe Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratur për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit... ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:*

- i. listën e kontratave të lidhura;*
- ii. shumën e kontraktuar;*
- iii. palët kontraktuese dhe përkrahësit e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur një pjesë e informacionit të kërkuar rezulton publik në mënyrë proaktive në programin e tij institucional të transparencës.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, në lidhje me të njëjtën objekt kërkesë për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në*

përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Pranimin e ankesës nr. 683 Prot., datë 30.03.2022, të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 10.03.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (“1. Për kontratën e lidhur mes OST dhe kompanisë DH Albania, për ndërtimin e linjës 220 kilovolt Burrel-Peshkopi dhe traktin dalës të nënstacionit të Burrelit, cilat kanë qenë kriteret vlerësuese për firmën fituese të këtij tenderi? 2. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e thirrjes së hapur për tender publik për shfaqje interesi; 3.Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e kriterëve vlerësuese për ofertuesit pjesmarrës; 4. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e kontratës së lidhur mes OST dhe DH Albania, e firmosur nga palët kontraktore”), brenda datës 23 . 5 .2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 5 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

